

VENDIM
Nr. 45, datë 19.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedjakryetar i Gjykatës Kushtetuese

Sokol Berberi	anëtar i	“	“
---------------	----------	---	---

Vitore Tusha	anëtare e	“	“
--------------	-----------	---	---

Gani Dizdari	anëtar i	“	“
--------------	----------	---	---

Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
---------------	----------	---	---

Fatos Lulo	anëtar i	“	“
------------	----------	---	---

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
-----------------	----------	---	---

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 35 Akti, që i përket:

KËRKUES: Vehab Aliu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia Tiranë, Shoqëria Përmbartimore “JUS” sh.p.k.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosëkzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; nen 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Bashkia Tiranë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqëria përmbartimore “Jus” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e Bashkisë Tiranë të vijojë procedurat për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional në posedim të tij, që shtrihet në pasuritë e paluajtshme nr. 5/17 dhe nr. 5/603, me sipërfaqe totale 270 m² dhe ndërtesë 101.5 m², të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8360, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 937, datë 25.2.2015, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, detyrimin e subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, të vijojë procedurat për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional në posedim të kërkuarit, si dhe të përmbushë detyrimet ndaj tij, duke përfshirë shpenzimet gjyqësore, të cilat përfshijnë shpenzimet e procedurës së ekzekutimit dhe tarifën për vënien në ekzekutim.

3. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 937, datë 25.2.2015 ka marrë formë të prerë në datën 12.3.2015, pasi nuk është ankimuar nga subjekti i interesuar Bashkia Tiranë.

4. Me shkresën e datës 2.4.2015, kërkuarisi i është drejtuar Bashkisë Tiranë për ekzekutimin vullnetar të këtij vendimi.

5. Duke qenë se Bashkia Tiranë nuk ka marrë asnjë masë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të lartpërmendur, në datën 8.5.2015 kërkuarisi i është drejtuar shoqërisë përmbartimore “Jus” sh.p.k. për vënien në ekzekutim të tij.

6. Me shkresën nr. 761/1 prot., datë 12.5.2015 shoqëria përmbartimore “Jus” sh.p.k. i ka

kërkuar subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015, ndërsa me shkresën nr. 761/2 prot., datë 25.5.2015, ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit *de quo*.

7. Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 6907/1 prot., datë 10.6.2015, në përgjigje të shkresave të sipërcituara, në zbatim të VKM-së nr. 608, datë 5.9.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri në 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, i ka bërë me dije kërkuesit se për të vënë në ekzekutim kërkesën e tij, ky i fundit duhet të depozitonte pranë saj (Bashkisë) dokumentacionin që provon plotësimin e kushteve të kërkuara nga VKM-ja.

8. Duke qenë se subjekti i interesuar Bashkia Tiranë nuk ka vijuar me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, me shkresën nr. 761/3 prot., datë 29.10.2015, shoqëria përmbarimore “Jus” sh.p.k., në zbatim të neneve 519, 523, 527 dhe 589 të KPC-së, i ka rikujtuar Bashkisë Tiranë ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

9. Pavarësisht shkresave të lartpërmendura, subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, nuk e ka ekzekutuar vendimin e formës së prerë.

II

10. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

11. **Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë**, ka prapësuar me shkrim në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

11.1. Kryetari i Bashkisë Tiranë, bazuar në VKM-në nr. 608, datë 5.9.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri në 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, me urdhrin nr. 271, datë 25.2.2013 dhe urdhrin nr. 6301, datë 29.4.2014, ka vendosur ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e VKM-së nr. 608, datë 5.9.2012. Këto grupe pune kanë për qëllim shqyrtimin e kërkesave dhe të dokumentacionit të depozituar nga individët sipas procedurës së përcaktuar në VKM-në e lartpërmendur.

11.2. Bashkia Tiranë nuk e ka ekzekutuar vendimin e formës së prerë sepse vetë kërkuesi ka qenë pengesë në zbatimin e tij, pasi nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për vijimin e procedurave, sikurse i është bërë me dije edhe shoqërisë përmbarimore me shkresën nr. 6907/1 prot., datë 10.6.2015.

12. **Subjekti i interesuar, shoqëria përmbarimore “JUS” sh.p.k.**, në prapësimet me shkrim të depozituara ka paraqitur një kronologji të vepri-meve përmbarimore e konkretisht:

12.1. Me shkresën nr. 761/1 prot., datë 12.5.2015, shoqëria përmbarimore “Jus” sh.p.k. i ka kërkuar subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015; me shkresën nr. 761/2 prot., datë 25.5.2015 i ka kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë; me shkresën nr. 761/3 prot., datë 29.10.2015, në zbatim të neneve 519, 523, 527 dhe 589 të KPC-së, i ka rikujtuar subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me iniciimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë

shtruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 17, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po ashtu, ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, në jurisprudencën kushtetuese është konsideruar tashmë si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Për pasojë, Gjykata vlerëson se çështja objekt shqyrtimi përfshihet në rrethin e çështjeve të juridiksionit kushtetues.

15. Në rastin në shqyrtim, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si edhe shërbimit përmbarimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ai ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

16. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 28, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithashtu, Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohë-zgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të çështjes duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhen analizuar të gjitha elementet e sipërcituar.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

19. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë (12.3.2015) deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë 1-vjeçare. Gjykata çmon se një periudhë e tillë për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor (apo fillimin e procedurave për ekzekutimin e vendimit) konsiderohet si një afat i paarsyeshëm.

ii) Kompleksiteti i çështjes

20. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt ekzekutimin e një vendimi gjyqësor nga Bashkia e Tiranës, e cila konsiston në vijimin e procedurave për regjistrimin e një objekti dhe të truallit funksional në posedim të kërkuesit. Bashkia e Tiranës, me shkresën nr. 6907/1 prot., datë 10.6.2015, ka

argumentuar se për vijimin e procedurave duhet të plotësohen kriteret kualifikuese të parashikuara në VKM-në nr. 608, datë 5.9.2012. Sipas Bashkisë Tiranë, bazuar në VKM-në e lartpërmendur, procedurat e regjistrimit mund të ndiqen vetëm për trojet funksionale që rezultojnë në pronësi të shtetit dhe jo ato me “pronar të pavërtetuar”, si në rastin e kërkuarit. Gjithashtu, në prapësimet me shkrim të paraqitura nga subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, rezulton se me urdhrin nr. 271, datë 25.2.2013 dhe urdhrin nr. 6301, datë 29.4.2014 është vendosur ngritja e grupeve të punës për zbatimin e VKM-së nr. 608, datë 5.9.2012, të cilat kanë si qëllim shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të depozituar nga individët sipas procedurës së përcaktuar në VKM-në e lartpërmendur. Në këtë drejtim, sipas Bashkisë Tiranë vetë kërkuari ka qenë pengesë në zbatimin e vendimit të formës së prerë, pasi nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për vijimin e procedurave.

22. Gjykata vlerëson se këto argumente të subjektit të interesuar kanë qenë objekt i gjykimit të themelit dhe rezultojnë të jenë analizuar dhe zgjidhur tashmë nga një vendim gjyqësor, i cili nuk është ankimuar nga subjekti i interesuar. Për pasojë, Gjykata çmon se çështja nuk paraqitet komplekse, duke qenë se zgjidhja e problemit faktik, që lidhet me fillimin e procedurave për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk e bën çështjen komplekse në atë shkallë sa që të përbëjë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor.

23. Përderisa çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, Gjykata vëren se vlerësimi i sjelljes së kërkuarit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Sjellja e kërkuarit

24. Gjykata është shprehur se kohëzgjatja tej afateve të arsyeshme për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuarit, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

25. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuari nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka ndjekur rigorozisht të gjitha veprimet e nevojshme juridike për të finalizuar të drejtën e tij të fituar gjyqësisht, duke iu drejtuar fillimisht vetë Bashkisë së Tiranës e pastaj përmbaruesit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar dhe duke shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

iv) Sjellja e autoriteteve

26. Për të përcaktuar sjelljen e autoriteteve në këtë çështje është e nevojshme të vlerësohet nëse shoqëria përmbarimore dhe Bashkia Tiranë kanë marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë.

27. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej ineffektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat

zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata çmon se përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka shfrytë-zuar disa prej mjeteve procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, pasi pas lajmërimeve për ekzekutimin vullnetar dhe të detyrueshëm nuk ka kryer asnjë veprim tjetër (të tilla si vendosje gjobe etj.). Këto veprime të përmbaruesit, gjithsesi, kanë rezultuar të pasuksesshme.

31. Për sa u përket veprimeve të palës debitore, Bashkisë Tiranë, ajo ka refuzuar të fillojë procedurat për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional në posedim të kërkuarit, që burojnë nga vendimi gjyqësor, me argumentin se kërkuari nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për vijimin e procedurave, i cili provon plotësimin e kushteve të kërkuara nga VKM-ja nr. 608, datë 5.9.2012. Pavarësisht këtij argumenti, Bashkia e Tiranës jo vetëm nuk ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin që kërkohet të ekzekutohet, por as veprimet përmbartimore. Për më tepër, sikurse u përmend më lart, kriteret e parashikuara nga VKM-ja në fjalë janë marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka arritur në përfundimin se është vetë subjekti i interesuar që ka shkëlur përcaktimet e pikës 6/ç të VKM-së, pasi nuk ka përgatitur relacionin teknik, i cili përmban përshkrimin e hollësishëm për verifikimin e kryer dhe përgjigjen e specifikuar për çdo kush të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, punonjësit e Bashkisë Tiranë nuk kanë kryer asnjë verifikim në terren, por kanë konkluduar për mosplotësim të kushteve nga ana e kërkuarit pa përfunduar kryerjen e veprimeve që VKM-ja i ngarkon institucionit të autorizuar (Bashkisë).

32. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Bashkia Tiranë duhet të merrte të gjitha masat, si dhe të gjente mjetet e duhura për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe jo të paraqiste arsye për ta penguar atë.

33. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretë-ndimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo